



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 4552/11 Prot.

Tiranë, më 3 . 12 .2019

**Lënda:** Kërkohet shkëmbim informacioni për listat e kandidatëve prokurorë që plotësojnë kushtet për hedhjen e shortit për zgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

**Drejtuar:** **Zotit Gent IBRAHIMI**  
**KRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

**TIRANË**

*I nderuar zoti Ibrahim,*

Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shkresë nr. 901 prot, datë 15.11.2019, ka përcjellë pranë Presidentit të Republikës, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret për t'u përfshirë në short për zgjedhjen e anëtarëve të KED (2020).

Institucioni i Presidentit të Republikës me shkresat nr. 4329/1 prot, datë 22.11.2019 dhe nr. 4468/1 prot, datë 02.12.2019, ka kërkuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë informacion shtesë dhe të azhurnuar në kohë, për listat e kandidatëve prokurorë që plotësojnë kushtet për hedhjen e shortit për zgjedhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Në përgjigje të kërkesave tona, Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shkresë nr. 935/1 prot, datë 02.12.2019, ka kthyer përgjigje, duke na vënë në dijeni se KLP në datë 15.11.2019 ka publikuar në faqen zyrtare listën e kandidatëve prokurorë të cilët plotësonin kushtet ligjore për t'u përfshirë në shortin për zgjedhjen e KED për vitin 2020, si dhe listën e kandidatëve që nuk i plotësonin kushtet dhe kriteret ligjore në këtë proces.

Gjithashtu KLP informon se, në datë 22.11.2019 ka njoftuar dhe shtatë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet dhe kriteret dhe deri në datë 02.12.2019, KLP nuk ka një informacion apo njoftim zyrtar për depozitim të ankimit lidhur me këtë vendimarrje të KLP-së, pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Në lidhje me informacionin e dërguar ju falenderojmë paraprakisht, por Institucioni i Presidentit të Republikës, kërkon gjithashtu bashkëpunimin tuaj për shkëmbimin e informacionit midis institucioneve tona deri në momentin e hedhjes së shortit, përcaktuar për t'u zhvilluar në datë 5 dhjetor 2019, ora 12:00.

Ky shkëmbim informacioni është shumë i domosdoshëm për integritetin e procesit, pasi në zbatim të pikës 1 dhe 2 të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016, në short për zgjedhjen e anëtarëve të KED, mund të përfshihen vetëm ata kandidatë të cilët **deri në momentin e organizimit dhe hedhjes së shortit, plotësojnë kushtet dhe kriteret e këtij neni.**

Konkretisht në nenin 221, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, konkretisht përcaktohet se:

Neni 221

***Kushtet dhe kriteret për t’u përfshirë në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit dhe procedurat e përzgjedhjes***

*1. Mund të përfshihen në shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi vetëm ata magjistratë dhe gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, të cilët, **në momentin e organizimit të shortit, plotësojnë kushtet e mëposhtme:***

- a) **në kohën e hedhjes së shortit** magjistrati që ushtron detyrën pranë gjykatave administrative, gjykatave të apelit, prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe Prokurorisë së Përgjithshme ka ushtruar funksionin e magjistratit për të paktën 10 vjet;*
- b) **nuk ka një masë disiplinore në fuqi;***
- c) **nuk ka filluar një procedim disiplinor para kandidimit;***
- ç) **shfuqizuar me ligjin nr.47/2019***
- d) **shfuqizuar me ligjin nr. 47/2019.***
- dh) **magjistrati është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në 2 vlerësimet e fundit etike dhe profesionale, nëse janë të disponueshme;***
- e) **magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është nën hetim ose nuk është dënuar më parë me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;***
- ë) **magjistrati ose gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk është dënuar më parë me sanksion administrativ për shkelje të rregullave ligjore në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesave.***

***2. Kandidatët që nuk plotësojnë një nga këto kushte përjashtohen nga shorti”.***

**Pra, kandidati duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e mësipërme ligjore jo vetëm në momentin e dërgimit të listave nga institucioni juaj që përkon me datën 15.11.2019, por ky detyrim ekziston për t’u përmbushur deri në momentin e organizimit dhe hedhjes së shortit që në rastin konkret Presidenti i Republikës ka përcaktuar për t’u zhvilluar në datë 5 dhjetor 2019, ora 12:00.**

Në këtë mënyrë Presidenti i Republikës në mbështetje të nenit 92 germa h të Kushtetutës dhe pikës 1 dhe 2 të nenit 221, të ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, kërkon nga ana KLP që të informohet në vijimësi por gjithmonë përpara datës 5 dhjetor 2019, ora 12:00, për çdo rrethanë apo fakt, që Këshilli administron, apo mund të vijë në dijeni pas datës 15.11.2019, gjë e cila mund të cenojë plotësimin e kushteve dhe kriterëve nga prokurorët e përfshirë në listën e dërguar nga ana juaj me shkresë nr. 901 prot, datë 15.11.2019.

***Duke ju falënderuar për bashkëpunimin në pritje të një përgjigje nga ana juaj,***

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**ORNELA ZONJA**

